STATE OF NEW YORK | EXECUTIVE CHAMBER

ANDREW M. CUOMO | GOVERNOR

Për njoftim të menjëhershëm: 14 qershor 2013

GUVERNATORI CUOMO NJOFTON NJË SHTESË TJETËR PREJ 39 MILION DOLLARË NË FONDIN PËR KËSHILLIMIN PËR KRIZËN E SHKAKTUAR NGA SANDY

Megjithëse ka ndihmuar mbi 170,000 njerëz, Fondi Federal për Projektin Shpresa (Federal Funding for Project Hope) vazhdon angazhimin për të ndihmuar njujorkezët në nevojë

Guvernatori Andrew M. Cuomo njoftoi sot për një shtesë tjetër prej 39 milion dollarë që i jepet Nju Jorkut nga Agjencia Federale e Menaxhimit të Emergjencave (Federal Emergency Management Agency) (FEMA) për të vazhduar projektin Project Hope, një program këshillimor për krizën për të mbijetuarit e super-stuhisë Sandy. Si total, projekti Project Hope ka marrë mbi 58 milion dollarë nga FEMA dhe u ka shërbyer mbi 170,000 njujorkezëve në nevojë.

"Pas super-stuhisë Sandy gjashtë muaj më parë, dëmet e Nju Jorkut nuk ishin vetëm shkatërrimet e lëna prapa por edhe lëndimet shpirtërore dhe mendore të shumë njerëzve", tha Guvernatori Cuomo. "Projekti Project Hope u krijua për të plotësuar nevojat jetësore të mbi 170,000 njerëzve që kishin nevojë për ndihmë dhe nëpërmjet këtij fondi shtesë, ne do të vazhdojmë angazhimin tonë të thellë për të ndihmuar njujorkezët t'i bëjnë ballë tragjedisë që është ende e freskët në mendjet e tyre".

Project Hope është një program këshillimi për krizën me orientim drejt qytetarit dhe ka për qëllim kryesor të ndihmojë njujorkezët të kthehen në gjendjen e tyre mendore dhe funksionale që kishin përpara stuhisë. Këshilltarët për krizat sigurojnë këshillime konfidenciale, edukim publik dhe koordinojnë lidhjet me burimet kaq të nevojshme që i ndihmojnë të mbijetuarit të ecin përpara për rindërtimin e jetës së tyre. Mbështetja jepet në mënyrë konfidenciale dhe falas në vendin dhe kohën e përshtatshme për të mbijetuarin. Këshilltarët për krizat shkojnë në qendrat e komunitetit, vendet e faljes, si dhe në shtëpi për tu takuar dhe biseduar me të mbijetuarit e të gjitha moshave.

Project Hope punëson mbi 800 banorë të Nju Jorkut të cilët janë punësuar brenda komuniteteve ku banojnë ata dhe 676 prej tyre janë staf këshillimor për krizat me shërbim direkt e me kohë të plotë. Stafi i Project Hope shkon në zonat më të dëmtuara si në komunat Nassau, Suffolk, Rockland dhe Westchester si dhe në të pesë lagjet e qytetit të Nju Jorkut.

Këta këshilltarë për krizat janë në vijën e parë të frontit dhe shpesh herë janë njerëzit e parë që

kontaktojnë të mbijetuarit e super-stuhisë Sandy. Sipas stafit të Project Hope, shembujt e mëposhtëm japin një pamje të asaj që ata shohin përditë.

- Këshilltarët për krizat takohen me të mbijetuarit në një vend të përshtatshëm për ta, gjë që i jep mundësi një djali nga Long Island të bisedojë privatisht me prindërit dhe këshilltarët për krizat rreth asaj se si filloi të urinojë në shtrat pasi super-stuhia Sandy i shkatërroi shtëpinë. Project Hope lidhi familjen e tij me shërbimet më të zgjeruara këshillimore brenda komunitetit dhe ai filloi të marrë ndihmën e nevojshme për të marrë veten.

- Project Hope krijoi një grup mbështetës në një bibliotekë lokale në Staten Island, duke lidhur së bashku njerëzit nga i njëjti komunitet, duke u treguar në këtë mënyrë se nuk ishin të vetëm. Project Hope u dha atyre rastin për të biseduar rreth përvojave vetjake dhe të mësonin se çfarë bënin fqinjët e tyre për tu rimëkëmbur nga stuhia.

- Project Hope ndihmoi një nënë nga Rockaways e cila e mendonte veten si të humbur dhe të pa zonjën për të qëndruar e fortë për fëmijët e saj. Këshilltarët tanë për krizat dëgjuan shqetësimet e saj dhe i mësuan mekanizmat e përballimit që e ndihmuan të rifitojë kontrollin që mendonte se e kishte humbur. Tani ajo i ndihmon fëmijët e saj të përballojnë stresin e shkaktuar nga Sandy.

“Sigurisht, shumë njerëz janë ende të pushtuar nga dëshpërimi dhe stresi”, tha drejtori i programit Project Hope, Ken Gnirke. Ai shtoi, “Disa prej të mbijetuarve do tu duhen muaj për të mbledhur veten nga efektet e këtij shkatërrimi. Këshilltarët tanë për krizat do të vazhdojë të shkojnë në komunitetet për të ndihmuar njerëzit të kuptojnë dhe të përballojnë reagimet e tyre ndaj situatës së re të shkaktuar nga kjo ngjarje e jashtëzakonshme që u ndryshoi jetën”.

Megjithëse ata do të vazhdojnë të ofrojnë këshillime për krizën në mënyrë individuale dhe në grup, ekipet e Project Hope së shpejti do të fillojnë të shtrijnë rolin e tyre për të promovuar zhvillimin e grupeve mbështetëse me qëllim që komunitetet më së fundi të qëndrojnë me forcat e veta. Në muajt e ardhshëm, Project Hope do të vazhdojë edhe me edukimin e të mbijetuarve me strategjitë e përballjes si dhe burimet në dispozicion në lidhje me shkatërrimet.

“Ne kemi një nivel të lartë të përgjegjësisë me qëllim që të ofrojmë shërbime cilësore për të mbijetuarit dhe kemi fatin të kemi agjenci dhe staf me njohuri, të motivuar dhe të zotë për të siguruar suksesin e Project Hope. Qoftë kur ndihmojnë për të zgjedhur përparësitë për dikë që të ecë përpara, qoftë kur ofrojnë sugjerime dhe lista referimi, përpjekjet e kombinuara të stafit të Project Hope kanë siguruar shërbime këshilluese konfidenciale për krizën që kanë ndryshuar jetën e dhjetëra mijëra njujorkezëve”, tha Gnirke.

Për më tepër informacion rreth Project Hope, lutemi merrni në telefon LifeNet në një nga numrat e mëposhtëm dhe pyesni për “Project Hope”. Telefonuesit referohen me kujdes të agjencia e tyre lokale Project Hope e cila e njeh komunitetin dhe është e gatshme t'i ndihmojë për të marrë veten.

Albanian

Për të kontaktuar LifeNet, lutemi telefononi:
Anglisht: 1-800-543-3638
Spanjisht: 1-877-298-3373
Gjuhët aziatike: 1-877-990-8585
(TTY: 212-982-5284).

###

Lajme të tjera do t'i gjeni në www.governor.ny.gov
Shteti i Nju Jorkut | Executive Chamber | press.office@exec.ny.gov | 518.474.8418